



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 355 Akti

Nr.481 Vendimi
Tiranë, më 7.12.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Olsi Komici	Relator
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 7.12.2021 mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Elidon Papazisi**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrër.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- 1.** Subjekti i rivlerësimit Elidon Papazisi, gjatë periudhës së rivlerësimit kalimtar, ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër. Në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.
- 2.** Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në datën 12.11.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, zhvilloi procedurat e shpërndarjes së çështjeve me short, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Elidon Papazisi do t’i nënshtrohej procesit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Suela Zhegu, Genta Tafa (Bungo) dhe Olsi Komici. Relator i çështjes me short u zgjodh komisioneri Olsi Komici.
- 3.** Menjëherë pas hedhjes së shortit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
- 4.** Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin e datës 18.11.2019, vendosi fillimin e hetimit administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisioneren Suela Zhegu. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
- 5.** Në datën 3.12.2019, subjekti i rivlerësimit u njoftua nëpërmjet postës elektronike mbi fillimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, për përbërjen e trupit gjykues, si dhe iu kërkua të shprehej nëse ishte në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e tij.
- 6.** Në datën 3.12.2019 subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike, njoftoi Komisionin se nuk është në konflikt interesi me asnjë prej anëtarëve të trupit gjykues.
- 7.** Trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, me vendimin e datës 19.10.2021 vendosi të mbyllë hetimin kryesisht ndaj subjektit të rivlerësimit Elidon Papazisi për të tri kriteret e rivlerësimit, atë të vlerësimit të pasurisë, kontrollin e figurës dhe aftësitë profesionale dhe po në datën 19.10.2021 subjekti u njoftua në rrugë elektronike për rezultatet e hetimit dhe të drejtën për t’u njohur me dokumentacionin e dosjes, si dhe mbi afatin për kthimin e përgjigjeve dhe depozitimin e provave brenda datës 3.11.2021, ora 16:00.
- 8.** Subjekti i rivlerësimit Elidon Papazisi, në datën 20.10.2021, konfirmon marrjen dijeni të vendimit të Komisionit dhe në datën 2.11.2021 i kërkoi Komisionit dy ditë afat shtesë për konsultimin e çështjes nga avokati i tij.
- 9.** Në datën 3.11.2021, Komisioni i njoftoi subjektit pranimin e kërkesës së tij, shtyrjen e afatit deri më 5.11.2021 dhe datën e seancës dëgjimore datë 10.11.2021, ora 14:00.

10. Po në datën 3.11.2021, subjekti i njofton me *e-mail* Komisionit kërkesën e tij për ndërprerje të procesit të vlerësimit, bazuar në germën “a”, të pikës 1, të nenit 64 dhe në pikat 1 dhe 2, të nenit 65, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në paragrafët 1 dhe 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës, duke dërguar në rrugë elektronike në Komision kërkesën përkatëse, të cilën e kishte depozituar edhe pranë KLGJ-së, gjithashtu edhe përmbajtjen e vendimit nr. ***, datë 3.11.2021, të KLGJ-së mbi deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Elidon Papazisi, gjyqtar i Gjykatës Administrative së Shkallës së Parë Gjyrokastër, për shkak të dorëheqjes së tij.

11. KLGJ-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 15.11.2021, e protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 15.11.2021, njoftoi deklarin e mbarimit të statusit për shkak dorëheqjeje të subjektit Elidon Papazisi, duke bashkëngjitur kërkesën për dorëheqje nr. ***, datë 25.10.2021, si dhe vendimin nr. ***, datë 3.11.2021, të KLGJ-së.

12. Me vendimin nr. ***, datë 3.11.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka vendosur: (1) deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak dorëheqjeje të z. Elidon Papazisi me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër; (2) urdhri i fillon efektet në datën 30.11.2021; (3) përjashtimin e gjyqtarit Elidon Papazisi nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër; (4) të njoftohen për këtë vendim, z. Elidon Papazisi; (5) kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Apelit.

13. Komisioni, me shkresat nr. ***, datë 23.11.2021 dhe nr. ***, datë 23.11.2021, ka kërkuar, respektivisht, nga KLGJ-ja dhe nga Gjykata Administrative e Apelit të konfirmojnë nëse nga subjekti i rivlerësimit Elidon Papazisi është bërë ankim ndaj vendimit nr. ***, datë 3.11.2021 dhe nëse ky vendim ka marrë formë të prerë.

14. Gjykata Administrative e Apelit, me shkresën nr. ***, datë 6.12.2021, drejtuar Komisionit, konfirmon se deri në datën 3.12.2021, subjekti i rivlerësimit Elidon Papazisi nuk ka paraqitur ankim pranë kësaj gjykate kundër vendimit nr. ***, datë 3.11.2021, të KLGJ-së.

15. Në datën 6.12.2021, Komisioni, me anë të postës elektronike, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, e cila do t'i njoftohej në ditët në vijim¹ në mënyrë që subjekti ta shfrytëzojë ose jo këtë të drejtë.

16. Subjekti i rivlerësimit, në datën 6.12.2021 nëpërmjet postës elektronike, ka njoftuar Komisionin se nuk dëshiron që të marrë pjesë në seancën dëgjimore duke hequr dorë vullnetarisht nga kjo e drejtë.

II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

17. Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit Elidon Papazisi ka filluar në respektim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”

¹Ku subjekti ka të drejtë të shprehet në lidhje me përfundimin e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes nga statusi i magjistratit, duke mbajtur në konsideratë pikat 1 dhe 2, të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

18. Trupi gjykues i Komisionit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara më lart, konstaton se:

i) Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.

ii) Procesi i rivlerësimit ndaj tij nuk ka përfunduar me vendim sipas pikës 1 të nenit 58 dhe me një nga masat disiplinore respektive sipas nenit 59 “konfirmimi në detyrë”, të nenit 60 “pezullimi nga detyra dhe detyrimi për të ndjekur programin e trajnimit” dhe të nenit 61 “shkarkimi nga detyra”.

iii) Subjekti i rivlerësimit Elidon Papazisi ka ushtruar të drejtën për të dhënë dorëheqjen.

iv) Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dorëheqjen pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ky i fundit me vendimin nr. ***, datë 3.11.2021, ka vendosur deklarin e mbarimit të statusit të magistratit Elidon Papazisi, për shkak të dorëheqjes.

19. Neni 65 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magistratit nëpërmjet dorëheqjes².

20. Neni G i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon: *“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe, në këtë rast, procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”*.

21. Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar ndër të tjera lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon: *“[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës [...]”*.

22. Për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtës së subjektit për t’u dëgjuar, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në rrugë elektronike, ka njoftuar subjektin në datën 6.12.2021, meqenëse nga KLP-ja është konfirmuar dorëheqja e tij me vendimin nr. ***, datë 3.11.2021, nëse ka vullnetin të marrë pjesë në seancë dëgjimore dhe se fokusi i kësaj seance do të jetë përfundimi i procesit të rivlerësimit me aplikim të nenit G, paragrafët 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës.

² “1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit”.

23. Subjekti i rivlerësimit, po në datën 6.12.2021, me anë të postës elektronike, ka njoftuar Komisionin se nuk dëshiron të marrë pjesë në seancën dëgjimore duke kërkuar, njëkohësisht, edhe ndërprerjen e procesit të rivlerësimit.

24. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka shfrytëzuar të drejtën që i njeh Kushtetuta dhe ligji, për dorëheqje nga statusi i magjistratit. Ndërprerja e procesit të rivlerësimit për shkak të dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t'u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit G, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në nenin 64 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Elidon Papazisi, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.
2. Ndalimin e emërimit të z. Elidon Papazisi si gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë e Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare.
3. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall, në datën 7.12.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU

Kryesuese

Olsi KOMICI

Relator

Genta TAFA (BUNGO)

Anëtare

*Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj*